



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjës së parë të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur më 26.07.2022,
duke filluar në orën 16:00.**

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit: Violeta Salihu (VV), Besart Krasniqi (VV), Dhurata Jahaj -Retkoceri (LDK), Gëzim Mehmeti (AKR), Leonora Shabani - Bajraktari (eksperte e jashtme).

Në mbledhje morën pjesë edhe: Donjeta Sahatçiu (nënkyetare), dhe Pretime Preniqi (koordinatore për NJDNJBGJ).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Violeta Salihu**, kryesuese e Komitetit për Barazi Gjinore.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Barazi Gjinore;
2. Diskutim rreth përgatitjes së Planit të punës të Komitetit për Barazi Gjinore;
3. Organizimi i një punëtorie të përkrahur nga NDI ku do të diskutohen strategjia organizative lidhur me Planin e punës për shtator-dhjetor 2022 si dhe komplet viti 2022;
4. Të ndryshme.

Violeta Salihu, kryesuese paraprakisht i njoftoj anëtarët e Komitetit, se deri më datën 10 gusht është duke u menduar të organizohet një trajnim 1 ditor, diku këtu në Prishtinë, nga NDI, dhe në qoftë se dakordohemi mund ta caktojmë një datë kur do të mund ta mbajmë këtë trajnim. Në takim do të ishte mirë të merrnin pjesë edhe nënkyetarja si dhe disa nga drejtoret e drejtive komunale.

Pretime Preniqi, koordinatore për NJDNJBGJ, tha se para se të votohej me ekstraktin e procesverbalit të mbledhjës inauguruese, për shkak të pamundësisë së ardhjes në mbledhje, kisha disa vrejtje aty ku thuhej se Prishtina po qëndron më së keqti në aspektin

Faqe 1 nga 3

e barazisë gjinore nuk është e vërtetë, sepse sa i përket numrit të punësuarve në aspektin gjinore, gjinia femër e kalon numrin e gjinisë mashkullore. Pastaj kur flasim për regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve, Komuna e Prishtinës qëndron mjaft mirë në këtë aspekt. Komuna e Prishtinës qëndron keq te personat me aftësi të kufizuara, te buxhetimi i përgjithshëm gjinor, përjashtime bëjnë subvencionimi në bujqësi dhe kulturë aty ku gjinia femërore është mirë me subvencione.

Të gjithë anëtarët e komitetit unanimisht e votuan miratimin e ekstraktit të proceccverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Barazi Gjinore.

Donjeta Sahatçiu, nënkyetare, përshëndeti të gjithë anëtarët e komitetit e cila tha se si Komitetet, do ta kenë mbështjetjen e saj gjdo herë. Ajo njoftojë anëtarët e komitet me të gjitha punët që Komuna e Prishtinës është duke bërë në këto drejtime nga fillimi i këtij mandati. Tash së fundmi jemi takuar me ekipin e ri të USAID team, të cilët kanë dy tema kryesore prokurim dhe financa. Ne kemi kërkuar që së paku njëra prej tyre me pas ekspertizën e buxhetimit të përgjithshëm gjinor, sepse është koncept i ri në Komunë dhe nuk po kuptohet pse ekziston buxhetimi i përgjithshëm gjinor.

Ideja është që sipas analizës gjinore për zonën në kontekstin ku është, kemi përkrahje, si kryeqytet duhet ta kemi një zyrtar specifik për barazi gjinore dhe një zyrtar specifik për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kemi përgjegjësi të madhe, duhet ta formojmë një ekip në të kundërtën me një- dy persona nuk mundet me u rrit ajo çfarë dëshirojmë ne.

Leonora Shabani tha se fëmijët në shkolla i kemi diskriminuar gjithë, në shkolla nuk e marrin asnjë shërbimin e psikologut, shumica kryejnë punë administrative.

Librat shkollore i kemi pas me diskriminim gjinor dhe ne si komitet te ndikojm që sa më shumë këta femijë të ndihen të barabart.

Sa u përket subvencioneve, aty kemi paraparë për një ndarje të barabartë si të grave si të burrave dhe sidomos një përkrahje më të madhe për nënët që janë vetushqyese, për nënët që janë mbajtëse të familjeve.

Violeta Salihu tha se ne duhet ti vetdisojmë gratë që të aplikojnë sidomos nëpër viset rurale, është fjala që ka shumë projekte dhe shumë punë që ato mund të bëjnë edhe që kishin mundur të përkrahen nga drejtoritë përkatëse

Dhurata Jahaj-Retkoceri tha se me funksionimin e bashkësive lokale do të jet një pikë kyqe që ndikon edhe në aspektin gjinor. A është e rëndësishme për shembull që në kuadër të këtyre bashkësive rurale përvçese edhe me qenë kryetare grua edhe anëtarët e tjerë të asaj bashkësie lokale me qenë anëtarët do me thënë të dy gjinive duke u bazuar në Ligjin për barazi gjinore 50 me 50. Kjo ndikon për shkak se kur ka funksionuar mirë grupi i grave asambliste, kemi bërë vizita nëpër fshatra ka pasur fshatra të cilët p.sh gratë shumë pak kanë qenë të njoftuara me disa informata p.sh rasti i subvencioneve vetëm për arsy se ne këto bashkësítë lokale nuk ka pasur aty një grua e cila i ka informuar për këto kur janë dhënë subvencionet apo tjerat informata.

Faqe2nga3

Gëzim Mehmeti tha se nëse ka hapësirë ligjore që me qenë këshilli 50 me 50, atëherë do te ishte bë një ndryshim që mund ta marrim si iniciativë, sepse unë nuk kam has asnjëherë femër që ka qenë kryetare e bashkësisë lokale, prandaj mendoj se do te kishte pasur efekt indirekt nëse kishim pas mundësi me qenë 50 me 50, ka me qen një risi dhe inovacion nëse ndryshohet kultura ligjore.

Donjeta Sahatçiu tha se ideja ka qenë që të diskutuar është më e vështirë të realizohet sigurisht ka çështje politike aty, por duhet të shkojmë në zgjedhje të bashkësive lokale, sepse nuk ka asnjë kryesuese ne keto bashkësive lokale.

Premtime Preniçi tha se unë faktikisht si pikë të parë ose element të parë të pozitës sime e kam barazinë gjinore, por tash ajo koordinatore për të drejtat e njeriut është shuar, andaj është më se e nevojshme që të caktohet një zyrtar edhe për personat me aftësi të kufizuara, është një pikë që është më e ndieshme.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se sa i përket shkollave, Drejtoria e Arsimit, është ajo e cila i obligonë gjithë mësimdhënësit në çdo fillim të muajit ta mbajnë orën e parë çdo herë për barazinë gjinore dhe për dhunën në familje.

Gëzim Mehmeti tha se më vjen mirë që ka shumë ide produktive dhe se është takimi i dytë ndoshta çka unë kisha pasur dëshirë të ketë më shumë strukturë për këtë çka po flasim dhe të dimë se çka po bëjmë.

Mbledhja përfundoj në ora 17:40.

Procesmbajtesi
Arton Brahimë



Kryesuesja e komitetit
Violeta Salihu

Faqe3nga3